REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr 487 Prot   Tiranë, më 26.01. 2016

URDHËR

Nr. 28 datë 26.01.2016

PËR SISTEMIN E REFERIMIT DHE TARIFAT E SHËRBIMIT SHËNDETËSOR PUBLIK

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr 10107 datë 30.03.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr 44/2012 "Për shëndetin mendor",

URDHËROJ:

1. Çdo person që ka nevojë të marrë shërbim në institucionet shëndetësore publike duhet të paraqitet fillimisht tek mjeku i familjes/mjeku i përgjithshëm. Në momentin e paraqitjes te mjeku i familjes/mjeku i përgjithshëm personi i pasiguruar duhet të jetë i pajisur me kartën e identitetit dhe personi i siguruar me kartën e shëndetit dhe kartën e identitetit.

2. Nëse mjeku i familjes/mjeku i përgjithshëm gjykon që diagnostikimi apo trajtimi i rastit kërkon konsultë më të specializuar, atëhere e rekomandon për tek specialisti përkatës.

3. Personat e siguruar që paraqiten tek mjeku specialist dhe janë të pajisur me kartë shëndeti, kartë identiteti dhe letër rekomandimi nga mjeku i familjes/mjeku i përgjithshëm për konsulta mjekësore ose ekzaminime laboratorike apo imazherike, e marrin këtë shërbim pa pagesë.

4. Personat e pasiguruar që paraqiten tek mjeku specialist dhe janë të pajisur me kartë identiteti dhe letër rekomandimi nga mjeku i familjes/mjeku i përgjithshëm për konsulta mjekësore ose ekzaminime laboratorike apo imazherike, e marrin këtë shërbim me pagesë sipas Aneksit 1 kolona C, që i bashkëlidhet këtij urdhëri.

5. Personat që paraqiten tek mjeku specialist dhe nuk janë të pajisur me letër rekomandimi nga mjeku i familjes/mjeku i përgjithshëm për konsulta mjekësore ose ekzaminime laboratorike apo imazherike, e marrin këtë shërbim me pagesë sipas Aneksit 1 Kolona A, që i bashkëlidhet këtij urdhëri.

6. Personat referohen për shërbime të specializuara, analiza laboratorike dhe ekzaminime të tjera nga Qendra Shëndetësore drejt poliklinikës së specialiteteve në juridiksionin e së cilës ndodhet Qendra Shëndetësore sipas Aneksit 2 që i bashkëlidhet këtij urdhëri.

7. Mjeku specialist pranë poliklinikës së specialiteteve, e trajton ambulatorisht ose e shtron pacientin në spitalin bashkiak ose e referon atë për konsultë më të specializuar në

poliklinikën e specialiteteve të rajonit përkatës duke e pajisur me rekomandimin. Përjashtim nga rregulli i mësipërm bëhet për Bashkinë Kamëz,Vorë dhe Tiranë. Në këto bashki mjeku specialist pranë poliklinikave të specialiteteve, e referon pacientin sipas rastit në shërbimet e konsultave përkatëse pranë Qendrës Spitalore Universitare në Tiranë.

8. Mjeku specialist pranë poliklinikës së specialiteteve mund ta referojë rastin në poliklinika të tjera specialitetesh në rast të pamundësisë për të ofruar një shërbim përfshirë analiza laboratorike dhe ekzaminime imazherike.

9. Pacienti që trajtohet në një spital bashkiak dhe ka nevojë për diagnostikime, ekzaminime dhe trajtime që nuk sigurohen nga ky spital, dërgohet me epikrizë shoqëruese në spitalin rajonal pas konsultës së firmosur nga mjeku kurues dhe shefi i shërbimit spitalor. Vendimi i argumentuar për referimin e pacientit në një spital më të specializuar të dokumentohet në kartelën personale të pacientit. Të gjitha rastet e referuara për trajtim ose ekzaminim në një spital tjetër të dokumentohen në një regjistër të veçantë dhe të ruhen në arkivën e spitalit dërgues.

10. Mjeku specialist pranë poliklinikës së specialiteteve në rajon, e trajton ambulatorisht ose e shtron pacientin në spitalin e rajonit ose e referon atë për konsultë apo trajtim më të specializuar në shërbimin e konsultave te Spitaleve Universitare të pajisur me rekomandimin përkatës.

11. Pacienti që trajtohet në një spital rajonal dhe ka nevojë për diagnostikim, trajtim dhe ekzaminim më të specializuar, të pajiset me epikrizë dhe të dërgohet pranë Spitaleve Universitare, pas konsultës të firmosur nga mjeku kurues dhe shefi i shërbimit. Vendimi i argumentuar për referimin e pacientit në një spital më të specializuar të dokumentohet në kartelën personale të pacientit. Të gjitha rastet e referuara për kurimin ose ekzaminim në një spital tjetër, të dokumentohen në një regjistër të veçantë dhe të ruhen në arkivën e spitalit dërgues. Përjashtimisht në raste të veçanta (për arsye të largësisë gjeografike ose kur nuk ofrohen shërbime të specialitetit përkatës) pacienti që trajtohet në një spital Bashkiak mund të referohet për konsulta, ekzaminime apo trajtime në spitalin rajonal më të afërt.

12. Drejtoria e institucionit afishon në vende të dukshme mënyrën e organizimit të konsultës (vendin, ditën, orën) dhe tarifat për çdo konsultë apo ekzaminim mjekësor sipas Aneksit 1 kolona A, B dhe C që i bashkëlidhen këtij urdhëri.

13. Të gjitha rastet e përcaktuara si urgjenca mjekësore që referohen për trajtim spitalor nga shërbimi ambulator duhet të kenë rekomandimin nga mjeku i familjes/mjeku i përgjithshëm, ndërsa ata të dërguar nga spitali bashkiak për në spitalin rajonal ose spitalet universitare duhet të kenë epikrizën përcjellëse të firmosur dhe vulosur nga mjeku i rojes dhe shefi i shërbimit përkatës.

14. Nga ky rregull përjashtohen urgjencat mjekësore ekstreme ose sipas rekomandimit të Shërbimit Kombëtar të Urgjencës Mjekësore, kur pacienti shkon ose trasportohet direkt në spital.

15. Të gjitha shërbimet e urgjencës mjekësore ofrohen pa pagesë.

16. Personat e siguruar e përfitojnë recetën me rimbursim vetëm kundrejt zbatimit të sistemit të referimit.

17. Për diagnozë, trajtim dhe ndjekje të rasteve me çrregullime të shëndetit mendor, bazuar në ligjin nr.44/2012 "Për shëndetin Mendor" referimi bëhet si vijon:

a. Personi që dyshohet se vuan nga një çrregullim i shëndetit mendor, referohet nga mjeku i familjes/mjeku i përgjithshëm drejt Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor (QKSHM) për diagnostikim.
b. Me anë të rekomandimit pacienti vlerësohet nga mjeku psikiatër fillimisht dhe më pas nga gjithë ekipi multidisiplinar.
c. Rekomandimi me diagnozën dhe trajtimin medikamentoz i përcillet mjekut të familjes/mjekut të përgjithshëm, i cili ekzekuton recetën me rimbursim.
d. Kur kërkohet një konsultë apo rishikim trajtimi medikamentoz personi me çrregullime të shëndetit mendor duhet të jetë i pajisur edhe me rekomandimin e mjekut të familjes/mjekut të përgjithshëm.
e. Në kushtet kur personi me çrregullime të shëndetit mendor nuk mund të menaxhohet në komunitet bëhet referimi nga QKSHM drejt shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër.
f. Punonjësi social dhe infermieri i QKSHM ndjekin në dinamikë shtrimin e personit, dhe koordinojnë daljen e tij nga shërbimi me shtretër.
g. Një kopje e fletëdaljes mbahet nga QKSHM, mbi të cilën hartohet plani i trajtimit në vazhdimësi.

18. Moszbatimi i këtij urdhëri ndëshkohet sipas sanksioneve të vendosura në Ligjin nr. 10107, datë 30.03.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe atyre të vendosura në kontratat që institucionet shëndetësore kanë lidhur me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

19. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri të gjitha institucionet shëndetësore publike.

20. Urdhërat nr.526, datë 12.10.2009 "Për zbatimin e sistemit të referimit të pacientëve në shërbimin shëndetësor" dhe nr. 529, datë 26.10.2009 shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet nga data 1 shkurt 2016.

MINISTRI

ILIR BEQAJ

Aneksi I

	Tarifat per sherbimet mjekesore per pacientet ne Kujdesin Shendetesor Paresor, Ambulator dhe Spitalor, sektori publik	Kolona A	Kolona B	Kolona C
		Pa sistem referimi	Me sistem referimi	Me sistem referimi
			I siguruar	I pasiguruar
A	**Vizita ambulatore**			
1	Vizita tek mjeku i familjes	0	0	0
2	Vizite te mjeku specialist ne poliklinike	1500	0	100
3	Kryerja e injeksioneve (muskulare ,venoze, subkutane)	150	0	0
4	Manipulime mikrokirurgjikale ambulatore	500	0	0
5	Vizite te mjeku specialist ne spitalet universitare	3000	0	500
6	Vizite te mjeku specialist ne spitalet rajonale	2000	0	100
7	Vizite te mjeku specialist ne spitalet e rretheve	1500	0	100
B	**Tarifat e ekzaminimeve radiologjike**			
1	Rentgenoskopi Toraksi	500	0	100
2	Rentgenoskopi stomaku	500	0	100
3	Rentgenografi stomaku seriog	500	0	100
4	Rentgenografi gastro-intestinale	500	0	100
5	Rentgenografi gastrointestinale seriografi	500	0	100
6	Rentgenografi vertebre ne 1 projeksion.	300	0	100
7	Rentgenografi e gjithe kolones vertebrale	700	0	100
8	Rentgenografi e kokes	500	0	100
9	Radiografi Panoramex	800	0	100
10	Irrigoscopi+grafi	500	0	100
11	Urografi intraven.kontrast 60%	800	0	100
12	Urogiafi intraven. kontrast 75%	1000	0	200
13	Cistografia miksionale	800	0	100
14	Rentg. te ndryshem 1 projeksion	300	0	100
15	Kolecistografia intravenoze	1000	0	200
16	Kolecistografia orale	500	0	100
17	Tomografia (3 shtresa)	1500	0	200
18	Ekografi	1000	0	200
19	Ekografi te ndryshme me print	1500	0	200
20	Radiografi Thoraxi	500	0	100
21	Hysterosalpinografi	1500	0	200
22	Kolposkopi	2500	0	500
23	çdo seance fizioterapie	500	0	500
24	Mamografia	1000	0	0
C	**Tarifat per ekzaminime endoskopike**			
1	Fibrobronkoscopi	4500	0	2000
2	Fibrogastroskopi	4500	0	2000
3	Fibrokolonoskopi	4500	0	2000

Aneksi I

4	Rektomanoskopi	1500	0	500
D	**Tarifat per analizat e laboratorit klinik-biokimik**			
1	Gjak komplet	500	0	100
2	Urin komplet	200	0	100
3	Glicemia	300	0	100
4	Azotemia	300	0	100
5	Kreatinemi	300	0	100
6	Bilirubine totale	300	0	100
7	Bilirubine e fraksionuar	300	0	100
8	GGT	400	0	100
9	ALAT	300	0	100
10	ASAT	300	0	100
11	Fosfataza alkaline	300	0	100
12	LDH	300	0	100
13	CPK	300	0	100
14	Lipidograma	800	0	100
15	Proteina totale	300	0	100
16	Elektroforeza e proteinave	1000	0	200
17	Eketroforeza e Hb	800	0	100
18	Na +\K +	300	0	100
19	Kalcium total	200	0	100
20	Elektrolitet ne gjak	900	0	100
21	Sideremi	300	0	100
22	S.G.P.T.	300	0	100
23	S.G.O.T	300	0	100
24	Spermograma	500	0	100
25	Gaz analiza	300	0	100
26	PT	300	0	100
27	APTT	300	0	100
28	Fibronogjeni	300	0	100
29	Celula LE	500	0	100
30	Sekrecione nazale per eozinofile	300	0	100
31	Uricemi	300	0	100
32	HBA e glukozuar	700	0	100
33	TSH	1500	0	200
34	T3	1500	0	200
35	T4	1500	0	200
36	PSA	1500	0	200
37	CEA	1500	0	200
38	&FP	1500	0	200
39	Ferritine	1500	0	200
40	Kortizoli	1500	0	200

Aneksi I

41	LH	1500	0	200
42	FSH	1500	0	200
43	PRL	1500	0	200
44	DHEA-S	1500	0	200
45	Beta H.C.G.	1500	0	200
46	Testosteron	1500	0	200
47	Estradiol II	1500	0	200
E	**Tarifat per analizat e laboratorit Mikrobiologjik**			
1	Kulture sputumi	800	0	100
2	Hemokulture	1500	0	200
3	Likidet sterile	1500	0	200
4	Kulturat e puseve	800	0	100
5	Mikroskopi per sekrecionet vaginale per koke + candida+ trikomonas	1000	0	100
6	Kulture per sekrecionet vaginale koke + candida+ trikomonas	1000	0	200
7	Ekzaminimet per leishmania	1000	0	200
8	Urokultura	800	0	100
9	Ekzaminimet per myk	500	0	100
10	Ekzaminimet per malarje	1000	0	200
11	Fecet per parazit	500	0	100
12	Fecet per gjak okult	1000	0	200
13	HbsAg	1500	0	200
14	Wright	900	0	100
15	Widal	900	0	100
16	Weil-Felix	700	0	100
17	Ekzaminimet per gonore	800	0	100
18	Spermokultura	800	0	100
19	Pus per antibiogram	300	0	100
20	Koprokultura	800	0	100
21	Sekrecione gryke per koke	500	0	100
22	Sekrecione hunde veshi per koke	500	0	100
23	Sekrecione gryke hunde per kandida	500	0	100
24	Tokso Ig G	1500	0	200
25	Tokso Ig M	1500	0	200
26	Anti. Antitoxoplazmoze	1000	0	200
27	Anti. Anti- ekinokok	1000	0	200
28	Rubeole Ig G	1500	0	200
29	Rubeole Ig M	1500	0	200
30	C.V.M. Ig G	1500	0	200
31	C.V.M. Ig M	1500	0	200
32	Herpes	1500	0	200
33	Klamidia	1500	0	200

Aneksi I

F	**Tarifat e sherbimeve kur kerkohen analizat per efekt dokumentacioni ne Laboratorin Mikrobiologjik**			
	Laboratori Mikrobiologjik			
1	Anti HIV 1+2	1000	0	0
2	VDRL	1000	0	200
3	Anti HAV	1500	0	200
4	Anti HBC	1500	0	200
5	Anti HBS	1500	0	200
6	Anti HCV	1500	0	200
G				
H	**Sherbimi i alergologjis-pneumologji**			
1	Provat respiratore	800	0	100
2	Provat funksionale respiratore me proven e reversibilitetit	1500	0	200
3	Provat e alergjise	1000	0	200
I	**Sherbimi i Kardiologjise**			
1	EKG (elektrokardiograma)	500	0	100
2	Prova e holterit	1000	0	200
3	Prova ushtrimore e bicikletes	1200	0	200
4	EKO kardiake	2000	0	200
J	**Sherbimi i Otorino-Laringologjise (ORL)**			
1	Audiograma	1000	0	200
2	Vestibulometria	500	0	100
3	Timpanometria	500	0	100
4	Elektronistumografia	500	0	100
5	Lavazh i veshit	400	0	100
K	**Sherbimi i okulistikes**			
1	Fusha vizive	1000	0	200
2	Fundus okuli	400	0	100
3	Angioflurosinografia	400	0	100
4	Heqje molusku	200	0	100
5	Pterigion	800	0	100
6	Chalazion	600	0	100
L	**Sherbimi i mikrokirurgjise**			
1	Heqje e lipomave ne pjese te ndryshme te trupit	3000	0	1000
2	Kryerje cirkumcizio	5000	0	1000
3	Artocentreze	800	0	100
4	Shpimi I bulave te veshit	800	0	100
5	Kosto totale e abortit (perfshihen analizat dhe nderhyrja)	5000	0	5000

Aneksi I

6	Prova e pregnostikonit	1000	0	200
M	**Tarifat per sherbimin e Flebologjise**			
1	Skleroterapi 1 seance	1500	0	200
2	Flebectomi	2000	0	200
N	**Veprime Administrative**			
1	Komisioni Mjeko Ligjor	200	200	200
2	Leshimi i raporteve (per drejtim automjeti)	1000	1000	1000
3	Dhenie epikrize per efekt KML, KEMP cse jashte shteti	300	300	300
4	Dublikate Akti Mjeko-Ligjor	100	100	100
5	Deshmi raport mjeksor per drejtim automjeti per te huajt	1000	1000	1000
6	Leshim dublikate per flete analize	100	100	100
7	Leshime dublikate per raporte/vertetime per efekte dokumentacioni.,Kur kerkohet nga te tretet	100	100	100
8	Leshimi i raporteve (per leje perd0rimi te armeve)	1500	1500	1500
O	**Sherbimi I Anatomise Patologjike**			
1	Biopsite e te gjitha llojeve	3000	0	500
2	Citologjike	2500	0	500
3	Konsultat e preparateve histopatologjike	1500	0	200
4	Konsultat e strishave citologjike	1000	0	200
5	Konsultat nga blloqet	2000	0	200
6	Marrja e preparateve per jashte shtetit	1500	0	200
7	Marrja e blloqeve per jashte shtetit	1500	0	200
8	Marrja e preparateve dhe blloqeve per jashte shtetit	2500	0	200
9	Dhenia e dublikatave te pergjigjeve	200	200	200
P	**Laboratori Imunologjik**			
1	Antistreptolizinat	1000	0	200
2	Waler-rose	1000	0	200
3	Gama-latex	800	0	100
4	Komplementi serik ch 50	800	0	100
5	Komplementi c3	800	0	100
6	Komplementi c4	800	0	100
7	Inhibitori ciq	800	0	100
8	Imunoelektroforeza	600	0	100
9	Proteinuri Bence-Jones	600	0	100
10	Krioglobulinat	800	0	100
11	IGG+IGA+IGM	800	0	100
12	IGE Totale	800	0	100
13	Proteina C reaktive	900	0	100
14	Antitr. Antiberth.Totale	900	0	100
15	Anti AND	800	0	100

Aneksi I

16	Anti antiberth solubel	1000	0	200
17	Komplekset imune Qarkulluese	1000	0	200
18	Fenotipizimi Limfocitar CD3, CD4, CD8,CD9,CD10	1500	0	200
19	HLA B27	1500	0	200
Q	**Laboratori Citologjik**			
1	Kariotip me banda G	4500	0	1000
2	Kariotip me banda Q	5000	0	1000
3	Kariotip me banda R	4500	0	1000
4	Kariotip me banda C	4500	0	1000
5	Kariotip prometafizik me banda G	5000	0	1000
6	Kariotip prometafizik me banda Q	5000	0	1000
7	Kariotip prometafizik me banda R	5000	0	1000
8	Kariotip prometafizik me banda C	5000	0	1000
R	**Tarfiat e ekzaminimeve Neurokirurgji-Neurologji**			
1	EEG e Holterit	1500	0	200
2	EEG e kompjuterizuar	1500	0	200
3	Aparati Dantec	1000	0	200
4	Blink reflex	1000	0	200
5	Stimulim i perseritur	1500	0	200
6	EMG	1000	0	200
7	EMG-EMB	1200	0	200
8	PEV	2000	0	200
9	PEA	2000	0	200
10	PES	2500	0	500
11	Elektro encefalograma: (EEG standart)	2000	0	200
S	**Transfusioni I Gjakut**			
1	Testi i Coombs indirekt	700	0	0
2	Testi i Coombs direkt	1000	0	0
3	Grup gjaku	500	0	0

Aneksi II

	Bashkia	Poliklinika e Specialiteteve *	Qendra Shëndetësore
	Bashkia Malësi e Madhe	Malësi e Madhe/Shkodër	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Shkodër	Shkodër	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Has	Has/Kukës	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Tropojë	Tropojë/Kukës	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Fushë-Arrez	Pukë/Shkodër	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Vau i Dejës	Shkodër	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Pukë	Pukë/Shkodër	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Kukës	Kukës	QSH nëe territorin e Bashkiseë
	Bashkia Lezhë	Lezhë	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Mirditë	Mirditë	QSH nëe territorin e Bashkisë
	Bashkia Dibër	Dibër	QSH në territorin e Bashkiseë
	Bashkia Mat	Mat	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Kurbin	Kurbin/Lezhë	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Krujë	Krujë	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Klos	Mat	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Bulqizë	Bulqizë/Dibër/Mat	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Durrës	Durrës	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Shijak	Durrës	QSH në territorin e Bashkisë

	Bashkia Vorë	Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 3/Dispanseria	**QSh Vorë, QSh Prezë, QSH Bërxullë**
	Bashkia Kamëz	Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Paskuqan	**QSH Paskuqan, QSH Kamëz, QSH Bathore, QSH Koder-Kamëz**
	Bashkia Tiranë	Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 1/Dispanseria	**Q.SH. Nr.1 Q.SH. Nr.2 Q.SH. Nr.10 Q.SH. Studenti Q.SH. Baldushk Q.SH. Bërzhitë Q.SH. Dajt Q.SH. Krrabë Q.SH. Petrelë Q.SH. Shkozë**
		Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 2/Dispanseria	**Q.SH. Nr.6 Q.SH. Nr.8 Q.SH. Nr.9 Q.SH. Ndroq Q.SH. Vaqarr Q.SH. Pezë Q.SH. Kashar Q.SH. Selitë**
		Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 3/Dispanseria	**Q.SH. Nr.3 Q.SH. Nr.4 Q.SH. Nr.5 Q.SH. Nr.7 Q.SH. Farkë Q.SH. Sauk Q.SH. Shëngjergj Q.SH. Zall-Bastar Q.SH. B. Lumit Q.SH. Zall-Herr**
	Bashkia Kavajë	**Kavajë**	**QSH në territorin e Bashkisë**
	Bashkia Rrogozhine	**Kavajë**	**QSH ne territorin e Bashkisë**
	Bashkia Peqin	**Peqin / Elbasan**	**QSH në territorin e**

			Bashkisë
	Bashkia Elbasan	Elbasan	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Belsh	Elbasan	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Librazhd	Librazhd	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Prrenjas	Librazhd	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Lushnjë	Lushnjë	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Divjakë	Lushnjë	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Cërrik	Elbasan	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Fier	Fier	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Kucovë	Kucovë/Berat	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Ura Vajgurore	Berat	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Roskovec	Fier	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Patos	Fier	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Berat	Berat	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Poliçan	Berat	QSH ne territorin e Bashkisë
	Bashkia Gramsh	Gramsh/Elbasan	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Pogradec	Pogradec	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Pustec	Korçë	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Maliq	Korçë	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Korçë	Korçë	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Devoll	Devoll/Korçë	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Skrapar	Skrapar/Berat	QSH në territorin e Bashkisë

	Bashkia Mallakastër	**Mallakastër/Fier**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Memaliaj	**Tepeienë/Gjirokastër**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Vlorë	**Vlorë**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Selenicë	**Vlorë**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Himarë	**Vlorë**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Tepelenë	**Tepelenë/Gjirokastër**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Këlcyrë	**Përmet/Gjirokaster**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Permet	**Permet/Gjirokastër**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Kolonjë	**Kolonjë**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Gjirokastër	**Gjirokastër**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Libohovë	**Gjirokastër**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Dropull	**Gjirokastër**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Delvinë	**Delvine/Sarande**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Sarandë	**Sarandë**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkia Finiq	**Sarandë**	QSH në territorin e Bashkisë
	Bashkla Konispol	**Sarandë**	QSH në territorin e Bashkisë

* Pacientet referohen nga QSH ne polikliniken e listuar te paren. Referohen nga QSH ne polikliniken e listuar te dyten ne rast te sherbimeve te munguara ne polikliniken e listuar te paren.